nënkupton detyrimet monetare të Barrëdhënësit ndaj Barrëmarrësit për të paguar Çmimin Shtesë të Blerjes 1 dhe/ose Çmimin Shtesë të Blerjes 2, në përputhje me nenet 2.3.3 dhe 2.3.4 të Marrëveshjes së Shitblerjes.

“Barrë Siguruese”

ka kuptimin që i jepet sipas Seksionit 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.

“Ligji për Barrët Siguruese”

do të thotë ligjin shqiptar “Për Barrët Siguruese”, nr. 8537, datë 18 tetor 1999, i ndryshuar, së bashku me rregulloret që rregullojnë Regjistrin e Barrëve Siguruese.

“Periudha e Sigurisë”

do të thotë periudhën që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi deri në datën më herët të (i) datës në të cilën janë paguar Detyrimet e Sigurara në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme dhe të shkarkuara plotësisht ose (ii) 31 dhjetor 2035.

“Data e Zgjidhjes”

ka kuptimin që i jepet sipas Seksionit 2.05 (a) të kësaj Marrëveshjeje.

“Rast Krijues”

do të thotë (i) Mesatarja e Akumuluar e EBITDA të (“*EBITDA Moyen Retraité Cumulé*”) Shoqërive për pesë Vite Reference pas Datës së Përfundimit e barabartë ose më e lartë se 482,352 Euro, ose (ii) kryerja e një Shitje Kualifikuese nga Barrëdhënësi (“*Cession Qualifiante*”).

“Kuotat Truen”

do të thotë kuotat e zotëruara nga Barrëdhënësi në kapitalin e Truen, që përfaqëson 100% të kapitalit të Truen.

“Aksionet WEnerg”

do të thotë aksionet e zotëruara nga Barrëdhënësi në kapitalin aksionar të WEnerg, që përfaqëson 100% të kapitalit aksionar të WEnerg.

“Aksionet/Kuotat Aktuale”

do të thotë bashkërisht Kuotat Truen dhe Aksionet Wenerg.

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë njëjtesin përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë persona përfshijnë shoqëritë, ortakëritë dhe personat e tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasardhësit e tij dhe të caktuarit e lejuar.

Në këtë Marrëveshje, një referencë për një Nen ose Seksion të specifikuar do të interpretohet si një referencë për atë Nen ose Seksion të specifikuar në Marrëveshjeje.

Në këtë Marrëveshje, një referencë për një marrëveshje do të interpretohet si një referencë për një marrëveshje të tillë që mund të ndryshohet, plotësohet, rinovohet ose cedohet herë pas here.

Në këtë Marrëveshje, titujt janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 2 - BARRA E SIGURIMIT

Seksioni 2.01 Garancitë e Barrëdhënësit për Barrën Siguruese

Si garanci për pagesën dhe përmbushjen e Detyrimeve të Siguruara në kohën e duhur, Barrëdhënësi jep këto garanci për Barrëmarrësin, një interes sigurie të rradhës së parë mbi Kuotat Truën dhe një interes sigurie të rradhës së dytë në formën e një barre siguruese të rradhës së dytë mbi Aksionet WEnerg ("**Barrë Siguruese**").

(b) Aksionet/Kuotat e mëposhtme ("**Aksionet/Kuotat e Ardhshme**") do të paguhet, emetohen ose shpërndahen tek, ose nga blerja e, Barrëdhënësi bëhet pjesë e Kolateralit dhe i nënshtrohet Barrës Siguruese:

- 1) të gjitha aksionet/kuotat, përveç Aksioneve/Kuotave Aktuale, të lëshuara nga secila Shoqëri, ose ndryshe të blera nga, ose të transferuara tek Barrëdhënësi, qoftë si rezultat i ndonjë dividendi në natyrë, konvertimi, ndarjeje, bashkimi ose çfarëdo arsye tjetër; dhe
- 2) të gjitha paratë e shpërndara në lidhje me Aksionet/Kuotat Aktuale dhe/ose Aksionet/Kuotat e Ardhshme kundrejt Barrëdhënësit nëpërmjet kthimit të kapitalit, dividendëve ose shpërndarjeve të tjera të pagesave; dhe
- 3) të gjitha aksionet/kuotat e nënshkruara ose të marra për shkak të rritjes së kapitalit.

(Aksionet/Kuotat Aktuale dhe Aksionet/Kuotat e Ardhshme këtu do të referohen bashkërisht si "**Kolateral**").

Seksioni 2.02 Regjistrimi i Barrës Siguruese

- (a) Barrëmarrësi do të sigurojë që menjëherë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, por jo më vonë se 5 ditë pune nga Data e Hyrjes në Fuqi, Barra Siguruese regjistrohet rregullisht në Regjistrin e Barrëve Siguruese në përputhje me ligjin shqiptar.
- (b) Barrëdhënësi do të sigurojë që menjëherë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, por jo më vonë se 5 ditë pune nga Data e Hyrjes në Fuqi, Barra e Sigurimit regjistrohet rregullisht në Regjistrin Tregtar Shqiptar në përputhje me ligjin shqiptar.
- (c) Barrëdhënësi angazhohet në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar të nënshkruajë, dorëzojë, regjistrojë dhe të paraqesë çdo dokument siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në një mënyrë të kënaqshme për Barrëmarrësin për Barrën Siguruese të krijuar nga kjo Marrëveshje dhe Barrëmarrësi do të marrë rregullisht origjinalet e nënshkruara, së bashku me çdo dokument, regjistrim, dosje, njoftim, regjistrim, noterizim ose prova të tjera të kërkuara, sipas mendimit të arsyeshëm të Barrëmarrësit, për krijimin, vlefshmërinë, përsosjen ose përparësinë, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e Barrës Siguruese.

Seksioni 2.03 Garanci të Mëtejshme

Herë pas here, me shpenzimet e Barrëdhënësit, Barrëdhënësi do të nënshkruajë dhe do t'i dorëzojë Barrëmarrësit sa më parë të gjitha aktet, njoftimet dhe dokumentet e mëtejshme dhe të zbatojë këto regjistrime, aplikime dhe formalitete që Barrëmarrësi, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, mund t'i përcaktojë si të nevojshme ose të dëshirueshme (qoftë si rezultat i çdo ndryshimi në ligjin në fuqi ose ndryshe) për të marrë përfitimin e plotë të Barrës Siguruese dhe të drejtave dhe tagrave të dhëna këtu, dhe për të krijuar, ruajtur, përsosur ose mbrojtur Barrën Siguruese të dhënë këtu ose për t'i mundësuar Barrëmarrësit të ushtrojë ose zbatojë të drejtat dhe mjetet juridike sipas kësaj Marrëveshjeje me kusht që të mos ketë njoftime, ose pëlqime ose pranime nga, palët e ndonjë kontrate për të cilën Barrëdhënësi është gjithashtu palë.

Seksioni 2.04 Siguria e Vazhdueshme

Barra Siguruese e krijuar nga kjo Marrëveshjeje do të jetë ligjërisht detyruese për Barrëdhënësin, pasardhësit e tij dhe përfituesit e cedimit dhe do të mbetet në fuqi dhe në efekt të plotë për kohëzgjatjen e Periudhës së Sigurimit dhe do të përbëjë një sigurim të vazhdueshëm, pavarësisht nga çdo shlyerje e pjesshme e llogarisë ose një reduktim ose shlyerje e pjesshme ose e plotë e çdo shumë të detyrimit sipas Detyrimeve të Siguruara dhe në asnjë mënyrë nuk do të paragjykohet ose të ndikohet nga çdo ndryshim dhe/ose rinovim i Detyrimit të Siguruar, ndonjë Pengu tjetër, dëmshpërblimi ose garancie të dhënë nga Barrëdhënësi në favor të ndonjë pale tjetër ose ndonjë gjykimi ose urdhri të marrë nga Barrëmarrësi, në lidhje me çdo Detyrim të Siguruar.

Seksioni 2.05 Efektshmëria, Zgjidhja dhe Lirimi

- (a) Barra Siguruese e dhënë këtu do të hyjë në fuqi në datën që kushtet e mëposhtme janë përmbushur nga Barrëdhënësi dhe Shoqëritë ("Data e Hyrjes në Fuqi"):
 - i. Pasi banka OTP SH.A. u ka dhënë autorizim me shkrim Shoqërive për krijimin e Barrës Siguruese;
 - ii. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka miratuar me shkrim krijimin e Barrës Siguruese.
- (b) Barrëdhënësi dhe Shoqëritë do të depozitojnë aplikimin përkatës pranë OTP SHA dhe ERE brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje së bashku me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për marrjen e miratimeve. Barrëmarrësi dhe Shoqëritë do të ndërmarrin të gjitha hapat për të përmbushur kushtet e përmendura më sipër brenda 90 ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje. Nëse ndonjë nga kushtet e mësipërme nuk do të jenë përmbushur brenda periudhës 90 ditore, Barrëmarrësi do të ketë të drejtën për të kryer çdo veprim të kërkuar për plotësimin e këtyre kushteve.
- (c) Barra Siguruese e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë dhe të gjitha të drejtat përkatëse për Kolateralin do t'i kthehet Barrëdhënësit, në përfundimin e afatit të Periudhës së Sigurimit.
- (d) Nëse (i) asnjë Rast Krijues nuk ka ndodhur deri më 31 dhjetor 2030 ose (ii) asnjë Rast Krijues nuk ka ndodhur para datës 31 dhjetor 2030 dhe Barrëdhënësi ka përmbushur detyrimet e tij sipas rregullave të Marrëveshjes së Shitblerjes në lidhje me atë Rast Krijues, Barrëdhënësi mund ta zgjidhë Marrëveshjen duke dhënë njoftim me shkrim për Barrëmarrësin. Një njoftim për zgjidhjen e Marrëveshjes do të specifikojë se Rasti Krijues i parashikuar përkatësisht nga nenet 2.3.3 dhe 2.3.4 të

Marrëveshjes së Shitblerjes ka ndodhur dhe, nëse është e aplikueshme, që të gjitha detyrimet në lidhje me ndonjë Rast Krijues të ndodhur janë përmbushur rregullisht dhe do të caktojnë një datë të parakohshme të zgjidhjes, datë e cila nuk mund të jetë më e hershme se 3 muaj data data e njoftimit (“Data e Zgjidhjes”).

- (e) Barrëmarrësi, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, mund të kërkojë nga Shoqëritë çdo informacion ose dokument nëse e gjykon të nevojshme të verifikojë që nuk ka ndodhur asnjë Rast Krijues. Nëse Barrëmarrësi nuk i përgjigjet njoftimit të zgjidhjes para ose në Datën e Zgjidhjes, Marrëveshja do të konsiderohet e zgjidhur automatikisht në Datën e Zgjidhjes, pa njoftim ose veprim të mëtejshëm nga asnjëra Palë.
- (f) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve d) dhe e) më sipër, kjo Marrëveshje nuk do të zgjidhet në rast se Barrëmarrësi ka paraqitur një kërkesë përpara 31 dhjetorit 2030 se një Rast Krijues ka ndodhur dhe ka nisur procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në Marrëveshjen e Shitblerjes.

NENI 3 – PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Seksioni 3.01 Përfaqësimet dhe Garancitë

Barrëdhënësi përfaqëson dhe garanton që:

- (a) kjo Marrëveshje do të përbëjë një barrë siguruese të vlefshme dhe të përsosur mbi kolateralin në favor të Barrëmarrësit i krijuar në përputhje me Ligjin për Barrët Siguruese;
- (b) zotëron dhe ka të drejta, titull dhe interes të plotë për të gjithë dhe çdo pjesë të Kolateralit;
- (c) përveç Barrës Siguruese Ekzistuese, Kolaterali ose ndonjë pjesë e tij nuk i nënshtrohet asnjë Pengu, dhe Barrëdhënësi nuk është subjekt i asnjë kontrate, marrëveshjeje apo ligji, qoftë e kushtëzuar apo e pakushtëzuar, në bazë të së cilës mund të krijohet çdo Peng mbi Kolateralin ose ndonjë pjesë të tij; dhe
- (d) asnjë palë e tretë nuk ka opsionin ose të drejtën e refuzimit për të blerë ose për të zotëruar të gjithë ose ndonjë pjesë tjetër të Kolateralit.

NENI 4 - ANGAZHIMET

Seksioni 4.01 Kolaterali

(a) Nëse Barrëmarrësi nuk jep pëlqimin e tij paraprak me shkrim, Barrëdhënësi nuk do të:

- 1) me përjashtim të Barrës Siguruese Ekzistuese, krijojë ose lejojë të ekzistojë ndonjë Peng mbi Kolateralin ose ndonjë pjesë të tij, ose veçanërisht çdo barrë siguruese mbi Kolateralin ose ndonjë pjesë të tij;
- 2) të shesë, cedojë, transferojë, japë me qira, licencojë ose të tjetërsojë ose të zgjidhë zotërimin ose menaxhimin ose disponimin e tij të pronësisë mbi Kolateralit ose ndonjë pjesë të tij.

(b) Barrëdhënësi do të paguajë menjëherë çdo dhe të gjitha tatimet, taksat dhe detyrimet që i detyrohen ose vendosen mbi Kolateralin dhe çdo pjesë të tij dhe do të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera materiale në lidhje me Kolateralin.

NENI 5 – MJETET JURIDIKE

Seksioni 5.01 Zbatimi

(a) Nëse një Rast Mospërbushjeje ka ndodhur dhe po vazhdon të ndodhë, Barra Siguruese do të bëhet, me zgjedhjen e Barrëmarrësit, menjëherë e zbatueshme dhe Barrëmarrësi (në lidhje me të gjitha Detyrimet e Siguruara) autorizohet dhe i jepen tagrat në mënyrë të pakthyeshme pa njoftim të mëtejshëm për Barrëdhënësin dhe pa kërkesa të mëtejshme me anë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe kur e shohin të arsyeshme, subjekt i ligjit të aplikueshëm për të zbatuar të drejtat e tij si në vijim dhe për të ndërmarrë ndonjë nga veprimet e mëposhtme:

- 1) të nisë procedura ligjore për të rikuperuar Detyrimet e Siguruara për të të gjithë ose një pjesë të Kolateralit;
- 2) të aplikojë në gjykatë për një urdhër ekzekutimi për të sekuestruar të gjithë ose një pjesë të Kolateralit në përputhje me Ligjin për Barrët Siguruese dhe ligjet e tjera në fuqi dhe të transferuara për Barrëmarrësin;
- 3) të shesë të gjithë ose një pjesë të Kolateralit në një ose më shumë shitje publike ose transaksione private në përputhje me Ligjin për Barrët Siguruese; në këtë drejtim Barrëdhënësi pranon të bashkëpunojë plotësisht me Barrëmarrësin dhe të nënshkruajë dhe dorëzojë çdo marrëveshje ose dokument që konfirmojnë pajtimin e Barrëdhënësit për ushtrimin e këtyre të drejtave nga Barrëmarrësi, siç mund të kërkojë Barrëmarrësi;
- 4) të mbajë të gjithë ose një pjesë të Kolateralit dhe ta zbatojë atë për të kënaqur të gjithë ose një pjesë të Detyrimeve të Siguruara në shumën që do të përcaktojë Barrëmarrësi në përputhje me ligjin në fuqi, dhe të ketë të drejtë, por jo i detyruar os i kërkuar që të, shesë, transferojë ose disponojë një Kolateral të tillë me titull të qartë për ndonjë palë e tretë në kushte të tilla që Barrëmarrësi i sheh të arsyeshme;
- 5) përndryshe sekuestron, grumbullon, realizon, shet, jep me qira, merr para hua, liron për palët e treta, ose përndryshe trajton Kolateralin në atë mënyrë siç lejohet nga Ligji për Barrët Siguruese dhe ligje të tjera në fuqi, dhe Barrëdhënësi pajtohet që menjëherë të ofrojë akses të pakufizuar dhe posedim të kolateralit ose të ndonjë pjese të tij të ngarkojë dhe të ekzekutojë dhe dorëzojë çdo marrëveshje ose dokument që konfirmon Marrëveshja e Barrëdhënësit për ushtrimin e të drejtave të tilla nga Barrëmarrësi; dhe
- 6) të ushtrojë çdo të drejtë ose mjet tjetër juridik që i jepet Barrëmarrësit sipas Ligjit për Barrët Siguruese, ligjeve të tjera të aplikueshme ose kjo Marrëveshjeje.

(b) Me ndodhjen e një Rasti Mospërbushjeje, Barrëmarrësi mund t'i dërgojë një njoftim Barrëdhënësit dhe/ose Shoqërisë duke i informuar ata që (i) ka ndodhur një Rasti Mospërbushjeje dhe (ii) gjatë vazhdimit të Rastit të Mospërbushjes dhe derisa Barrëmarrësi të informojë me shkrim Barrëdhënësin dhe Shoqërinë se Rasti i Mospërbushjes nuk është më duke ndodhur, Barrëmarrësi do të ketë të drejtë, por nuk do të ketë asnjë detyrim, për të:

- 1) ushtrohet të drejtat e votës që i bashkëngjiten Aksioneve/Kuotave, si në rastet e zakonshme ashtu edhe në ato të jashtëzakonshme të mbledhjeve të Aksionarëve/Ortakëve të Shoqërisë; dhe
- 2) marrë të gjithë dividendët në lidhje me Aksionet/Kuotat.

(c) Çdo dividend i marrë në mënyrë të pakthyeshme nga Barrëmarrësi do t'i nënshtrohet çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, të zbatohet për të përmbushur Detyrimet e Siguruara në atë kohë të paguara. Barrëmarrësi do të ketë të drejtën e ekzekutimit të veçantë për të mbledhur çdo dividend ose pagesa të tjera drejtpërdrejt nga Shoqëria.

Seksioni 5.02 Aplikimi i të Ardhurave

Barrëmarrësi do të ketë të drejtën të shesë të gjithë ose një pjesë të Kolateralit dhe të gjitha të ardhurat e marra nga shitja e Kolateralit dhe të gjitha të ardhurat e të tjera të marra nga Barrëmarrësi në lidhje me zbatimin e Barrës Siguruese do të aplikohen për përmbushjen e Detyrimeve të Siguruara në këtë mënyrë pasi Barrëmarrësi e shoh të arsyeshme që i nënshtrohet çdo ndalimi sipas ligjit në fuqi.

Pavarësisht nga vlera e ndonjë pjese të Kolateralit (sido që të përcaktohet) që nga data e kësaj Marrëveshjeje ose nga koha e shitjes ose disponimit të Kolateralit ose e pranimit ose marrjes së tij nga Barrëmarrësi ose çdo palë e tretë, Detyrimet e Siguruara do të shlyhen vetëm në masën e të ardhurave reale të marra nga Barrëmarrësi nga një shitje ose disponim i tillë ose, në rast pranimi ose marrjeje, nga shitja ose disponimi i mëvonshëm i një Kolateralit të tillë sipas ligjit në fuqi. Në masën që këto të ardhura në fakt janë të mjaftueshme për të përmbushur Detyrimet e Siguruara në mënyrë të pakthyeshme në tërësi, në tepricë, nëse ka, do t'i paguhet Barrëdhënësit.

Seksioni 5.04 Nuk ka Përgjegjësi ose Detyra

Barrëmarrësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi si rezultat i marrjes në zotërim të Kolateralit ose ndonjë pjese të tij ose të ndonjë shitjeje të Kolateralit ose të ndonjë pjese të tij, përveçse për shkak të neglizhencës së tyre të rëndë dhe/ose mospërmbushjes së qëllimshme. Barrëmarrësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj Barrëdhënësit për të siguruar Kolateralin (qoftë në ruajtje apo në zotërim të tyre) dhe nuk do të kenë asnjë detyrë për t'u kujdesur ndaj Barrëdhënësit në lidhje me Kolateralin, përveç (i) detyrave të tilla që janë të detyrueshme nga ligji në fuqi dhe nuk janë subjekt i heqjes dorë, dhe (ii) detyrimi për të ushtruar një kujdes të tillë në mbajtjen dhe ruajtjen e Kolateralit gjatë mbajtjes ose zotërimit të Kolateralit nga Barrëmarrësi, siç është e arsyeshme që një huadhënës i siguruar të ushtrojë në lidhje me një Kolateral të tillë në mbajtjen ose zotërimin e tij.

Seksioni 5.05 Ushtrimi i të Drejtave

Të drejtat e Barrëmarrësit sipas këtij Neni 5 mund të ushtrohen aq shpesh sa është e nevojshme dhe nuk do të kufizohen ose limitohen në çfarëdo mënyre këto të drejta sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

NENI 6 - TË NDRYSHME

Seksioni 6.01 Marrëveshja e plotë; Ndryshimi dhe Heqja dorë

Kjo Marrëveshje përbën të gjithë detyrimin e palëve në lidhje me Marrëveshjen dhe do të zëvendësojë çdo shprehje paraprake të qëllimit ose mirëkuptimit në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim, heqje dorë nga Barrëmarrësi i ndonjë prej termave ose kushteve të, ose pëlqimit të dhënë nga Barrëmarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë, pa kufizim, këtë Seksion 6.01) do të jetë me shkrim, i nënshkruar nga Barrëmarrësi dhe, në rastin e një ndryshimi, edhe nga Barrëdhënësi.

Seksioni 6.02 Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të parashikuara këtu do të jepen në adresat e treguara më poshtë:

Nëse për Barrëmarrësin:

CN'Air

Rue Andre Bonin, 69004, Lyon, Francë

Për Kryetarin e Bordit të Drejtorëve

Me Kopje tek Shefi i Departamentit Ligjor

Nëse për Barrëdhënësin:

Ylliad

Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake 1, Kati 7, 1001, Tiranë, Shqipëri

Z. Julien Roche

Seksioni 6.03 Gjuha

(a) Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze.

(b) Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze. Nëse kjo Marrëveshje përkthehet në ndonjë gjuhë tjetër, versioni i saj në gjuhën angleze do të jetë versioni i zbatueshëm për të gjitha qëllimet.

Seksioni 6.04 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

Seksioni 6.05 Pasardhësit dhe Përfituesit

(a) Kjo Marrëveshje do të lidhet dhe do të funksionojë në dobi të pasardhësve dhe përfituesve përkatës të palëve këtu.

(b) Barrëmarrësi mund të shesë, transferojë, cedojë, rinovojë ose ndryshe të heqë të gjitha ose një pjesë të të drejtave ose detyrimet të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj çdo pale të tretë me pëlqimin paraprak të Barrëdhënësit. Në çdo ose në të gjitha rastet e tilla, Barra Siguruese do të vazhdojë të sigurojë Detyrimin e Siguruar.

Seksioni 6.06 Ndarshmëria

Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është, ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë juridiksion, një dispozitë e tillë do të shkëputet nga kjo Marrëveshje dhe nuk do të cenojë (i) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje

ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në çdo juridiksion tjetër të asaj dispozite ose të dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 6.08 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.



NË DËSHMI TË KËSAJ, kjo marrëveshje është hartuar dhe nënshkruar në katër kopje origjinale me të njëjtën vlerë.

Ylliad Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

[nënshkrimi]

CN'Air

Përfaqësuar nga:

[nënshkrimi]

[vulë:

CNR, President

Përfaqësues për Drejtorin e Përgjithshëm

Julien FRANCAIS]



Përktheu: Sara Ndreaj SM.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



V2024053950197238576

**DATE 29/04/2024
NR REP 3245**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 29/04/2024, para meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Sara Ndreaj, atësia Haxhi, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Kavajë, me adresë Mali Robit; Nd. 350; Golem; Golem; 2504; Kavajë, lindur më 28/10/2001, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038457810 dhe nr. personal K16028038S ,

Përkthyesia cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë;" në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU





**RËPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



V2024053950197159221

**DATE 29/04/2024
NR REP 3244**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 29/04/2024, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Sara Ndreaj, atësia Haxhi, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Kavajë, me adresë Mali Robit; Nd. 350; Golem; Golem; 2504; Kavajë, lindur më 28/10/2001, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038457810 dhe nr. personal K16028038S,

E cila me kerkoi tevertetoj dokumentin e njejte me origjinalin Marreveshja e Barreve Siguruese date 06.121.2023 lidhur ndermjet Ylliad Shpk dhe CN' Air.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU



10/10/10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 2411

Nr. koleksioni: 984

Tirane më 29/03/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024000020269623789



Titulli e Personit Liguide



A2024000020269623789

DEKLARATE NOTERIALE DHENIE PELQIMI PER BARRESIM AKSIONESH

Ne TIRANE, sot me date 29/03/ 2024 (dy mije e njezete e kater), perpara meje noteres Adri Doshani, anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega TIRANE, me adrese Rruga Adri Doshani pallati nr.13, u paraqit:

PERFITUESI: Shoqeria bankare "BANKA OTP ALBANIA" SH.A., me seli ne adresen Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Kulla 1, Kati i 9-te, Tirane, Shqiperi, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr. 30724 date 12.12.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, qe vepron si BANKE me Licensen Nr. 17 date 16.02.2004 te leshuar nga Banka e Shqiperise, me NIPT Nr. K41424801U, perfaqesuar nga **Menaxher i Departamentit Mbeshtetes te Korporatave, Z. Arben Jorgji**, i biri i Dhori, lindur ne Vlore, me 22.12.1962, banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit Nr. 035031498, dhe me nr. Personal G21222028U, leshuar date 06.11.2019, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar **dhe** nga **Menaxhere e Departamentit te Kontrollit te Kredise dhe Monitorimit Znj. Vilma Stankoviq**, e bija e Qemalit, lindur ne Tiranë, me 23.05.1984, banues ne adresen Rruga "Muhamet Deliu", Tiranë mbajttese e Pasaportes/ Leternjoftimit Nr.I45523037F madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan sa me poshte vijon, te cilet deklaruan sa me poshte vijon:

Banka (ish BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA) i ka akorduar Shoqerise WEnerg Sha nje kredi ne shumen 381,500,000 Leke (treqind e tetedhete e nje milion e peseqind mije leke) me ane te Kontrates Bankare Nr. 830 Rep, / 326 Kol date 11.12.2018 te noteres Meri Çela.

Per te siguruar shlyerjen e kesaj kredie eshte vendosur barre siguruese mbi 100% (njeqind perqind) te aksioneve te shoqerise kredimarrese WEnerg Sha. Kjo vertetohet nga Marreveshja e Barres Siguruese mbi Aksionet me Nr. 832 Rep, / 328 Kol date 11.12.2018 e noteres Meri Çela e regjistruar ne Regjistrin e Aksioneve te WEnerg Sha, ne Regjistrin Tregtare te Qendres Kombetare te Bisnesit si dhe Qendren e Aksioneve.

Aksionaret e Wenerg kane hyre ne nje marreveshje per shitblerje aksionesh date 01.06.2023 sipas ciles shoqeria shitese CN' AIR SAS ka shitur te gjitha aksionet e zoteruara prej saj ne kapitalin themeltar te WEnerg tek shoqeria blerese YLLIAD SHPK. Shoqeria YLLIAD SHPK do te jete ne vijim aksionar i vetem i shoqerise Wenerg Sha. Per shitjen e ketyre aksioneve, Banka ka dhene pelqimin e saj nepermjet deklarates noteriale me Nr 1648 Rep, / 865 Kol date 15.08.2023 te noter Edlira Telharaj.

Ndermjet shoqerive Ylliad shpk dhe CN' AIR eshte lidhur marreveshja e barres siguruese date 06.12.2023 me qellim dhenien e nje interesi sigurie te rradhes se dyte ne formen e nje barre siguruese mbi aksionet e WEnerg Sha.

Banka ne cilesine e saj si barremarrese e rradhes se pare mbi aksionet e shoqerise WEnerg Sha, nepermjet kesaj deklarate noteriale jep pelqimin e saj per vendosjen e nje barre siguruese ne rradhe te dyte ne favor te shoqerise CN' AIR me kushtin qe kjo barre te fshihet ne momentin e plotesimit te kushteve te parashikuara ne Kontraten e Cedimit te nenshkruar mes paleve date 01.06.2023.

Kjo Deklarate Noteriale u perpilua nga une Noteri ne 4 (kater) kopje origjinale konform vullnetit te lire te perfaqesuesve te Deklaruesit, te cileve pasi ju lexua me ze te larte dhe pasi e gjeten sipas vullnetit te tyre, e nenshkruan rregullisht para meje NOTERIT.





DEKLARUES

“BANKA OTP ALBANIA” SH.A.

perfaqesuar nga:

Menaxher i Departamentit Mbeshtetes te Korporatave

Z. Arben Jorgji

Arben Jorgji
[Signature]

Menaxhere e Departamentit te Kontrollit te Kredise dhe Monitorimit

Znj. Vilma Stankoviq

[Signature]
[Signature]



NOTER

Julian Zhelegu

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes

Nr. 186/19 Prot.,

Tiranë, më 08.04.2024

Lënda: Njoftim i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 02.04.2024

“TRUEN” SHPK

(Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla nr. 1, Kati 7, 1000, Tiranë)

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 02.04.2024, vendosi dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “TRUEN” shpk si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.

Nga ana Juaj të mbahet në konsideratë sa përcaktohet në këtë vendim.

Vendimi nr. 55/2024 publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në adresën www.ere.gov.al, në zërin Vendimet e Bordit, viti 2023. Ky vendim botohet dhe në Fletoren Zyrtare.

Duke ju falënderuar,

KRYETARI NË DETYRË
Erjola SADUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes

Nr. 185/ Prot.

Tiranë, më 22.04.2024

Lënda: *Njoftim vendimi nr. 71, datë 12.04.2024*

“WENERG” sha

(Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Nr.1, Kati 7, 1000, Tiranë)

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 12.04.2024, vendosi të japë autorizimin për vendosjen e barrës sigurorese të radhës së dytë mbi aksionet e shoqërisë “Wenerg” sha, në favor të “CN’AIR”.

Sa më sipër mbani në konsideratë, sa përcaktuar në kushtet e këtij vendimi.

Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 71, datë 12.04.2024 publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në adresën www.ere.gov.al, në zërin Vendimet e Bordit, viti 2024. Ky vendim botohet dhe në Fletoren Zyrtare.

Me respekt,

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI

